



Udhëzues për raportimin e



gjuhës së urrejtjes në internet



**NDRYSHIMI I GJUHËS**

**MUND TË NDRYSHOJË**

**BOTËN**



# NDRYSHIMI I GJUHËS MUND TË NDRYSHOJË BOTËN

Udhëzues për raportimin e gjuhës së urrejtjes në internet

## Autorët

Shkodran Ramadani  
Medina Murturi  
nga Qendra për studime të avancuara FIT

## Mbështetur nga:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Republika e Kosovës

## Editor:

Teuta Zymeri



Qendra për studime të avancuara FIT  
E-mail: [info@fit-ks.org](mailto:info@fit-ks.org)  
[www.fit-ks.org](http://www.fit-ks.org)



# PËRMBAJTJA

Hyrja.....	4
Si të mbroheni në rjetet sociale.....	5
Raportimi i gjuhës së urrejtjes në Facebook.....	6
Raportimi i gjuhës së urrejtjes nëInstagram .....	9
Raportimi i gjuhës së urrejtjes nëSnapchat .....	13
Raportimi i gjuhës së urrejtjes nëTikTok .....	15

## HYRJA

Qendra për Studime të Avancuara FIT(Qendra FIT ) me përkrahje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë ka përpiluar këtë udhëzues të detajuar për të rinjtë që përdorin rrjetet sociale, në mënyrë që t'i pajisë ata me njohuri të nevojshme për të raportuar gjuhën e urrejtjes në të cilën mund të hasin.

Kjo nismë është realizuar në kuadër të projektit “Ambasadorët e rinj kundër gjuhës së urrejtjes”.

Me këtë Udhëzues, kemi kënaqësinë t'u ofrojmë fëmijëve udhëzime për raportimin e gjuhës së urrejtjes në rrjetet më të njohura sociale, si: Facebook, Instagram, Snapchat dhe TikTok. Qëllimi ynë kryesor është të ngrisin vetëdijen në mesin e të rinjve për pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe që t'u ndihmojmë atyre në raportimin e gjuhës së urrejtjes që. Gjatë përpilimit të Udhëzuesit ne kemi marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjisë dhe jemi munduar që t'i përshtatim sa më mirë këshillat e sigurisë me rrjetet më të përdorura sociale nga të rinjtë.

Përveç të mirave të shumta, fatkeqësisht interneti ka edhe anët e tij të errëta. Interneti nuk është vetëm platformë që afron njerëzit mes vete, por edhe hapësirë ku njerëzit sulmojnë njëri-tjetrin. Ndër problemet që shkakton bota online është hapësira që u jepet përdoruesve të gjuhës së urrejtjes. Interneti mundëson që gjuha e urrejtjes e përdorur në një cep të botës, të lëndojë dikë në një cep tjetër. Këshilli i Evropës e definoi gjuhën e urrejtjes si kategori që përfshin të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen, diskriminimin, ksenofobinë dhe format e tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë (Këshilli i Evropës, 2018).

Ndërkohë universiteti prestigjioz anglez, LSE, urrejtjen në internet e definoi si gjuhë të urrejtjes e shprehur në internet ose përmes teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Ky universitet e përdorë edhe një shprehje për të përmbledhur gjithë këtë: “Cyberhate”. Urrajtja në internet njihet gjithashtu edhe si ekstremizëm virtual dhe konsiderohet si formë unike e dhunës kibernetike.

Ne inkurajojmë të gjithë të rinjtë që shfrytëzojnë rrjetet sociale që të përdorin këtë Udhëzues i cili u ndihmon ta identifikojnë gjuhën e urrejtjes dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të mirë për të gjithë.

# SI TË MBROHENI NË RRJETET SOCIALE?

Rrjetet sociale janë uebfaqe dhe aplikacione të cilat mundësojnë komunikimin virtual mes njerëzve në mbarë botën. Për të pasur një llogari në rrjete sociale kërkohen disa të dhëna personale si: emri, mbiemri, moshë, e-mail, fotografia personale, adresa, apo numri i telefonit. Në shumicën e rrjeteve sociale moshë e lejuar për hapje të llogarisë është mbi 13 vjeç.

Mirëpo, këtë kriter shumë fëmijë nuk e zbatojnë. Shumica e fëmijëve në Kosovë gënjajnë për moshën e tyre në mënyrë që të kenë mundësi të hapin llogari. Sot rrjetet sociale në internet janë mënyra më e përhapur e komunikimit nga të rriturit dhe fëmijët. Në bazë të hulumtimit “Siguria e fëmijëve në Internet”, të realizuar nga Qendra FIT, rrjetet sociale më të popullarizuara të fëmijët në Kosovë janë: Facebook, Youtube, Instagram etj.

Fëmijët përdorin këto rrjete kryesisht për të komunikuar dhe për t’u informuar për tema të ndryshme. Në rrjete sociale ata kanë mundësi edhe të postojnë fotografi, video, të luajnë lojëra, dhe të bëjnë shumë aktivitete të tjera. Për të pasur siguri më të madhe gjatë përdorimit të rrjeteve sociale ju duhet t’i:

**Raportoni sjelljet e dëmshme** - Rrjetet sociale kanë rregullat e tyre njësoj si shkolla që vendos rregulla për të përmirësuar jo vetëm procesin mësimor, por edhe marrëdhëniet mes nxënësve. Nëse ju vëreni që dikush në rrjetet sociale përdor gjuhë urrejtëse dhe në kundërshti me rregullat e tolerancës dhe mirësjelljes, ju mund t’i raportoni dhe është mirë ta bëni këtë gjë. Gjuha e urrejtjes nëpër rrjetet sociale dhe përmbajtjet që nuk janë të prapshme për moshën që keni duhet të hiqen që të mos i shihni më.

**Kujdes se çfarë postoni** - Kur postoni diçka në internet, vështirë se mund ta ktheni mbrapsht. Gati çdo gjë që thoni dhe secila fotografi që e postoni mund të kopjohet, të ndryshohet dhe të shpërndahet nga të tjerët. Prandaj, mos postoni çdo gjë që ju bie ndërmend sepse ato fotografi mund të përdoren kundër jush në të ardhmen.

**Respektimi të tjerët** - Vetëm sepse mund të ndiheni anonim në internet, s’do të thotë se gjuha e urrejtjes që ju përdorni nuk shkakton dëm. Si në jetën reale, ashtu edhe në atë virtuale veprimet e juaja kanë pasoja, prandaj respektoni njerëzit tjerë që janë pjesë e rrjeteve sociale.





# RAPORTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË FACEBOOK

Facebook është rrjeti social më atraktiv i përdorur nga të rinjtë Kosovarë. Rrjeti Facebook ofron mundësi për komunikim mes shokëve, postime të ideve, fotografive, videove, dhe materialeve të tjera të ngjashme. Është një rrjet social shumë i sofistikuar i cili çdoherë e më shpesh vjen me ndryshime në pamje, parametra të privatësisë, shumë mundësi të reja, por edhe me rreziqe të shumta.

Kur dikush ju dërgon mesazhe në Facebook duke shprehur gjuhë të urrejtjes ndaj jush, ju mund ta raportoni atë person duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

**Hapi i parë:** Ju duhet ta hapni kutinë e mesazheve, si tek Figura 1 dhe pastaj të klikoni tek **emri i personit**.

Figura 1. Parametrat





Figura 2. Privatësia



**Hapi i dytë:** Këtu keni një listë me opsione të ndryshme, mirëpo në këtë rast ju e zgjedhni opsionin **“Something’s wrong”**. (Figura 2).

**Hapi i tretë:** Këtu ju shfaqen opsione të ndryshme për të cilat mund të raportoni. Në këtë rast ju duhet të klikoni opsionin **“Hate Speech”** dhe e shtypni butonin **“Send Feedback”** (Figura 4)




Figura 4. Raportimi i gjuhës së urrejtjes

**Hapi i katërt:** Pasi që keni raportuar gjuhën e urrejtjes, Facebook ju falënderon për raportimin që e keni bërë, duke ju sugjeruar për ta bërë edhe një hap të radhës, pra ta bllokoni personin i cili ka përdorur ndaj jush gjuhë të urrejtjes. Në këtë rast, e zgjidhni opsionin **“Block”**. (Figura 5).




Figura 5. Sygjerimi për Bllokim

**Hapi i pestë:** Këtu e zgjedhni opsionin **"Block Messages and Calls"** (Figura 6), pastaj Facebook ju drejton në dritaren e radhës (Figura 7), duke ju pyetur se a dëshironi ta bllokoni këtë person. Pastaj ju e zgjedhni prapë opsionin **Block** dhe në dritaren tjetër (Figura 8), Facebook ju tregon se ky person është bllokuar.

Figura 6. Bllokimi i personit




Figura 7. Bllokimi i mesazheve dhe thirrjeve





Figura 8. Bllokimi final



Facebook jua jep mundësinë të bllokoni personat të cilët ju bezdisin. Që nga momenti kur e bllokoni një person, ai nuk do ta marrë asnjë njoftim që është bllokuar nga ju dhe nëse vendosë të ju kërkojë në Facebook nuk do të mundet të ju gjejë. Ju gjithashtu mund të bllokoni ftesa për ngjarje të ndryshme, programe të ndryshme, dhe faqe të ndryshme.



# RAPORTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË INSTAGRAM

Instagrami është një rrjet social shumë i popullarizuar që përdoret për shpërndarjen e fotografive dhe videove. Instagrami poashtu ofron mundësi për komunikim (chat). Shpërndarja e fotografive dhe videove posaçërisht është shumë atraktive për fëmijët ngaqë mundëson rregullimin e fotografive me filterë të ndryshëm. Videot mund të jenë nga 3 deri në 60 sekonda. Tek Rregullat e Instagramit thuhet se “Ju duhet t’i keni të paktën 13 vjet që të përdorni Instagramin”.


**Mënyra e raportimit të gjuhës së urrejtjes në Instagram** - Në rast se dikush përdor gjuhë të urrejtjes ndaj jush në rrjetin social Instagram, ju duhet të ndjekni hapat në vijim.

**Hapi i parë** - shkoni te kutia e mesazheve dhe personi që ka përdorë gjuhë të urrejtjes e selektoni bisedën (**Figura 1**), klikoni mbi të, do të shfaqet pamja si në (**figurën 2**) ku duhet të klikoni në ikonën e detajeve (e rrumbullaksuar me ngjyrë të kuqe në figurë). Pastaj do të shfaqet (**figura 3**) ku duhet të klikoni **Report**.

Figura 1. Kutia e mesazheve

Figura 2. Klikimi në ikonën e detajeve

Figura 3. Butoni Report



**Hapi i dytë:** Pasi të keni klikuar Report, nga ju kërkohet të shpjegoni çfarë lloj përmbajtje është measazhi që po e raportoni. Instagrami ju pyet nëse po e raportoni bisedën apo llogarinë e personit. Në këtë hap, ju e selektoni "**Report Chat**"(Figura 4).

**Hapi i tretë:** Pasi të keni klikuar **Report Chat**, hapet dritarja tjetër dhe duhet ta zgjidhni arsyen për të cilën po e bëni raportimin. Në këtë rast e zgjedhni "**It's inappropriate**" (që d.m.th përmbajtje e papërshtatme) Figura 5.

Figura 4. Raportimi i bisedës






Figura 5. Përmbajtja e raportimit




**Hapi i katërt:** Pasi që e keni selektuar "It's inappropriate", hapet dritarja me opsione të ndryshme për raportim. Në këtë rast, pasi qëllimi ynë është të raportojmë gjuhën e urrejtjes si te **Figura 6**, duhet të selektoni "**Hate Speech or Symbols**".

Pas këtij hapi, një dritare e re hapet (**Figura 7**) dhe ju tregon që Instagrami do të veprorë në mbylljen e llogarisë të këtij përdoruesi në qoftë se e zbulon se ky person përdor gjuhë të urrejtjes. Pastaj e shtypni "**Submit Report**" për ta dërguar raportimin.

**Figura 6. Raportimi i gjuhës së urrejtjes**



**Figura 7. Dorëzimi i raportimit**



**Hapi i pestë:** Pasi që e keni shtypur Submit Report, hapet dritarja e re dhe ju tregon që Instagram e ka pranuar raportimin tuaj (**Figura 8**), duke ju sugjeruar këtu që ta bëni bllokoni këtë person. Këtë veprim mund ta bëni, dukë e selektuar **“Block”** dhe pastaj pasi që e keni klikuar block (**Figura 9**), ju e keni bllokuar këtë person duke mos i lejuar ata më ta shohin profilin tuaj (**Figura 10**).




Figura 8. Pranimi i raportit

Figura 8. Sygjerimi për bllok





Figura 9. Bllokimi i personit



# RAPORTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË SNAPCHAT


Rrjeti social "Snapchat" për një kohë shumë të shkurtër është bërë shumë i popullarizuar sidomos nga të rinjtë. Snapchat është një aplikacion i cili mund të instalohet pa pagesë dhe të përdoret për shpërndarjen e fotografive, videove, vizatimeve, si dhe për të komunikuar me shokë/shoqe. Një veçori e Snapchat është se të gjitha fotografitë dhe videot e shpërndara zhduken brenda 10 sekondave kështu duke u ofruar përdoruesve të komunikojnë lirshëm pa pasjo afatgjate.

Raportimi i gjuhës së urrejtjes në Snapchat mund të bëhet duke shkuar në bazë të hapave të mëposhtëm:


**Hapi i dytë:** Pasi keni klikuar Report, ju hapet dritarja tjetër (**Figura 3**) me llojet e ndryshme të raportimit. Ju duhet të zgjedhni "**Spam Account**", që mund të përkthehet si llogari me përmbajtje bezdisëse).

**Hapi i parë:** Vizitoni profilin e personit i cili ju ka shkruajtur mesazhe me përmbajtje të papërshtatshme dhe pastaj te **Figura 1** klikoni në ato "**tri pikat**" vertikale, lart në anën e djathtë të aplikacionit. Nga këtu ju hapet një dritare e re (**Figura 2**), që ju ofron 3 opsione: për ta shtuar si shokë/shoqe, për ta bllokuar apo raportuar. Në këtë rast, e selektoni "**Report**".


**Figura 1. Profili i snap përdoruesit**



**Figura 2. Shtypja e butonit Report**



**Figura 3. Selektimi i llojit të Raportimit**




**Hapi i tretë:** Pasi që e kemi klikuar Spam Account, hapet dritarja e re (Figura 4) dhe i keni dy opsione në kuadër të raportimit. Nga këto opsione e zgjedhni "They sent me spammy or suspicious Snaps/Chats" (më kanë dërguar mesazhe apo foto me përmbajtje të dëmshme dhe të dyshimta). Pasi që e keni selektuar për cilën mënyrë raportoni, vazhdoni dhe e shtypni "Submit".

Tashmë, pasi që e keni klikuar Submit, Snapchat ju falenderon për raportimin e bërë dhe ju sygjeron që të vazhdoni edhe me bllokimin e profilit të këtij përdoruesi. Në këtë rast, te figura 5 e klikoni "Block" dhe në qoftë se e kërkonti këtë person në Search, nuk do të ju shfaqet më.

**Figura 4. Përzgjedhja e llojit të raportimit**

**Figura 5. Sygjerimi për bllokim**

**Figura 6. Vërtetimi që është bllokuar personi**



**Në secilin rrjet social sigurohuni që vetëm shokët tuaj të mund të ju kontaktojnë.**


# RAPORTIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË TIKTOK

TikTok nuk është rrjet social në të cilin komunikojmë. Mirëpo, aty mund të postojmë video dhe foto të ndryshme. Në TikTok gjuha e urrjetes shprehet më së shumti përmes komenteve në postimet tona. Prandaj, për të raportuar gjuhën e urrjetjes në TikTok, ndiqni hapat e mëposhtëm.


**Hapi i parë:** Vizitoni profilin e këtij personi dhe lart në të djathtë të aplikacionit shihen "tri pika" horizontale (**Figura 1**), klikoni në ato tri pika dhe menjëherë TikTok ju drejton në faqen tjetër (**Figura 2**), aty e keni opsionin "Report" dhe klikoni mbi të.

Hapi i dytë: Pasi keni klikuar Report, ne **Figurën 3** ju paraqiten dy opsione "Report Account" dhe "Report Content". Këtu e klikoni "Report Account", për arsye se jep më shumë opsione për të raportuar.


**Figura 1. Profili i TikTok përdoruesit**



**Figura 2. Shtypja e butonit Report**



**Figura 3. Raportimi i llogarisë**




**Hapi i tretë:** Kur e klikoni **Report Account**, shfaqet dritarja (**Figura 4**), e cila ju kërkon arsyen se pse po e raportoni këtë person. Në këtë rast e zgjedhni **"Posting Inappropriate Content"** (Postim me përmbajtje të papërshtatshme).

**Hapi i katërt:** Nga dritarja paraprake, TikTok ju drejton në dritaren tjetër (**Figura 5**), për të zgjedhur saktësisht se çfarë po raportoni. Këtu e selektoni **"Hate Speech"** dhe pas kësaj ju shfaqet dritarja në të cilën e shtypni **"Submit"** dhe pasi që e keni shtypur, Tik Tok ju falenderon për raportimin që e keni bërë duke kontribuar kështu që edhe në TikTok të ndalohet gjuha e urrejtjes.

**Figura 4. Selektimi i llojit të raportimit**

**Figura 5. Raportimi i gjuhës së urrejtjes**

**Figura 6. Dorëzimi i raportimit**





Sikur të gjitha rrjetet sociale që deri më tani na sugjeruan që t'i bllokojmë personat që përdorin gjuhë të urrejtjes, edhe TikTok e bën të njëjtën gjë. Kjo tashmë shihet se është shumë e lehtë sepse hapave të njëjtë kaluam edhe tek rrjetet sociale të mësipërme.

**Hapi i pestë:** Pasi që e keni dorëzuar raportimin ndaj personit të cilin e keni identifikuar në TikTok, TikTok ju sygjeron që ta bllokoni këtë person. Në këtë rast, ju e klikoni "**Block**"(Figura 7).


**Hapi i gjashtë:** Pasi që e keni klikuar **Block**, TikTok ju tregon që ju nuk do ti shihni postimet e njëritjetrit (Figura 8).

**Hapi i shtatë:** Në këtë hap, ju shfaqet shiriti me "**ngjyrë të hirtë**" (Figura 8), për të ju treguar që ky person është bllokuar përfundimisht.

Figura 7. Sygjerimi për bllokim

Figura 8. Klikimi i butonit "Block"

Figura 9. Bllokimi i personit në TikTok



## KONKLUZIONE

Rrjetet sociale janë një mjet i mirë dhe i shpejtë për komunikim dhe shpërndarje të informacioneve. Megjithatë ato ofrojnë edhe rreziqe nëse nuk mësoheni si t'i përdorni në të mirën tuaj. Për të pasur një përvojë sa më të këndshme dhe të sigurt në rrjetet sociale, janë disa gjëra që duhet t'i mbani në mend:

- Nëse jeni nën moshën 13 vjeçare, mos hapni llogari në rrjetet sociale deri sa të mbërrini moshën e duhur dhe pa u konsultuar me prindërit.
- Mbani llogarinë tuaj private në mënyrë që të mbroheni nga keqpërdorimi dhe përvetësimi i informatave personale.
- Mos pranoni si shokë personat që nuk i njihni dhe mos komunikoni me ta.
- Mos u dërgoni fotografi tuajat apo të të afërmeve tuaj personave që nuk i njihni.
- Shmangni përdorimin e mundësisë për "check in" në mënyrë që të pamundësohet identifikimi i vendndodhjes tuaj nga keqbërësit.


Respektoni rregullat e mirësjelljes gjatë përdorimit të rrjeteve sociale, ashtu si do t'i respektonit rregullat në familje dhe në shkollë.

Krijoni një kontratë me rregulla për përdorim të internetit, për të cilat do të bisedoni hapur së bashku dhe do të nënshkruhet nga të dy palët: ju dhe prindërit tuaj.

**MOS HARRONI:** janë disa informata me ndjeshmëri të lartë, të cilat nuk duhet assesi t'i shpërndani kur jeni online dhe veçanërisht gjatë përdorimit të rrjeteve sociale.

- Adresën e shtëpisë;
- Emrin e shkollës;
- Email adresën;
- Numrin e telefonit;
- Vendin ku jeni;
- Vendin ku planifikoni të shkoni në të ardhmen e afërt.

Nëse mbani parasysh këto këshilla dhe i ndiqni udhëzimet që i kemi përgatitur në këtë Udhëzues, do ta kaloni kohën në rrjete sociale me më pak brenga se do të keqpërdoren informatat që ju i postoni apo do të hasni në gjuhën e urrejtjes dhe kështu përdorimi i rrjeteve sociale do të jetë më i këndshëm e i sigurt.



Qendra për studime të avancuara  
Center for advanced studies

## Qendra për studime të avancuara FIT

Adresa: Rruga Eqrem Çabej, nr 166,  
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

E-mail: [info@fit-ks.org](mailto:info@fit-ks.org)  
[www.fit-ks.org](http://www.fit-ks.org)  
[www.internetisigurte.org](http://www.internetisigurte.org)